



Prishtinë 31 mars 2016  
Kodi i ZRRE: V\_801\_2016

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit);
- Parimet e vendosjes së ngarkesave për gjeneratorët e rregulluar;
- Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar;
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE10) me dokumentacionin relevant sqarues;
- Vendimi\_V\_797\_2016 për të Hyrat Maksimale të Lejuara për operatorët e licencuar Termocentrali Kosova A dhe Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar);dhe
- Kërkesën e datës 25 mars 2016 të dorëzuar ZRRE për miratimin e çmimeve të rregulluara KEK Gjenerimit.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **APROVOHEN** çmimet e rregulluara që do të zbatohen nga operatori i licencuar i Termocentralit Kosova A dhe operatorit i licencuar Termocentrali Kosova B (Gjeneratorët e Rregulluar) për vitin relevant tarifor SHTE10 duke filluar nga data 1 prill 2016.

## ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK), më datë 25 mars 2016 aplikacionin për çmime të rregulluara të KEK-Gjenerimit;
- ✚ Në marrjen e vendimit për MAR që do të mbulohet nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes çmimeve të rregulluara, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së:
  - Raport Konsultativ - Llogaritja e Kostos së Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 shkurt 2016;
  - Raport Konsultativ-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Ngarkesave të Gjeneratorit të Rregulluar, i publikuar me datën 24 shkurt 2016; dhe
  - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i tarifave të energjisë elektrike SHTE10, i publikuar me datën 31 mars 2016.



- I. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e ngarkesave për kapacitet dhe energji për KEK- Gjenerimin, që do të zbatohet nga data 1 prill 2016, përkatësisht në vitin relevant tarifor SHTE10 është dhënë tabelën e mëposhtme.

Elementet Tarifore	Njësia	Tarifa
Ngarkesa për Energji	€/MWh	8.32
Ngarkesa për Kapacitet	€/MW/h	19.83


- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar,

  
Arsim Janova, anëtar,

  
Qemajl Mustafa anëtar,

  
Besim Sejfi anëtar.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.